

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi <i>Burim ZEKU</i>	Data e autorizimit të ekspertit 11.01.2023	Data e dorëzimit të raportit 18.01.2023	Nr. i lëndës: 23-24/23
--	---	---	-------------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.01.2023, OE "ER-LIS Shpk" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 23/23, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "LURN Shpk"- Fushe Kosove, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish 21shit dhe ishe-Shtypshkronjës së Rilindjes" me nr. të prokurimit: 214-22-13394-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Me datën: 09.01.2023, OE "BLENOR Shpk" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 24/23, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "LURN Shpk"- Fushe Kosove, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish 21shit dhe ishe-Shtypshkronjës së Rilindjes" me nr. të prokurimit: 214-22-13394-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 90,054.75 €, kriteri i dhënies, Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Procedurat e zhvilluara deri në ankesë të dorëzuar nga OE janë:

Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit.....	24.11.2022
Procesverbali i hapjes së ofertave.....	06.12.2022
Njoftimi mbi vendimin e AK-se.....	21.12.2022
Kërkesa për rishqyrtim BLENOR Shpk.....	23.12.2022
Kërkesa për rishqyrtim ER-LIS.....	27.12.2022
Vendimi i AK-se në kërkesat për rishqyrtim.....	30.12.2022
Ankesat në OSHP – ER-LIS SHPK.....	09.01.2023
Ankesat në OSHP – BLENOR SHPK.....	09.01.2023

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Operatori Ekonomik ER-LIS SHPK ne ankesën e tij pretendon se janë shkelur dispozitat si ne vijim:

Neni 1 i LPP-së Oëllimi

Neni 6 –I LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 69 i LPP-së Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shitesë
Neni 38.3 i RROUPP saktësishtë neni 39.3 i RROUPP

Njoftimi për eliminim dt 24.12.2022 me arsytimin se:

1. Nuk kemi ofruar Vendimin per Menaxherin e Kontrates, siç kane qenë kërkesat në njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e Tenderit

2. Përsonei për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor. Ju keni ofruar dëshmi vetëm për nëntë nga stafi i cili do të angazhohet për këtë projekt. Për Kërkesen 2 ne DT është kërkuar

Pas Njoftimit për eliminim kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim dt 24.12.2022 me sqarime:

Për Kërkesen 1 ne DT është kërkuar

Kërkeses 2: Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

KERKESA 1. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV-mbi përvojën e punës në lëmin e kërkuar, kontrata ose marrëveshja e punësvalide për këtë projekt me punëdhënësin-kopje. Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi.

Kërkesa 1, kemi dorëzuar:

- Diplomen e noterizuar përkatëse nga origjinali
- CV-mbi përvojën e e punës në lëmin e kërkuar
- Kontraten për këtë projekt me vendim për caktimin e Menaxherit të projektit inenshkuar nga Punëmarrësi, nenshkrua dhe vulosur nga Punëdhënësi.

Dëshmi 1:

KONTRATË PUNE

- PËR KOHË TË CAKTUAR 06.12.2022

.....
- Punëmarrësi: **SH. P.**, i lindur, No LN:72 me profesion: **Inxhinjer i diplomuar i Ndertimitarise drejtimi Konstruktiv**

Neni 2


I punësuar do të kryej punët si: **Menagjer i Projektit**

Neni 3

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolimi, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.

Dëshmia 2:

Lista e punetorev 06.12.2022- e nënshkruar dhe vërtetuar


ER-LIS
SH.P.K.

12.2022

LISTA E STAFIT UDHEHEQES TEKNIK DHE FUQISE PUNETORE

Eksperiencia-Pervoja		
Shpëtim Morina	- Menaxher i përgjithshëm	20 vite
Shaban Pllana	- Menaxher për keta projekt	30 vite
Shpresa Maraj	- Nënpunese	5 vite
Venera Morina	- Eksperte për Logjistike	5 vite
Kamer Kameraj	- Punëtor	15 vite
Maxhil Beqiri	- Udhëheqës teknik Vozites	15 vite
Diedon Shala	- Voz - Ekonomist	10 vite
Naim Uka	- Vozites- Makinist	5 vite

Egzon Maraj -Logjistike
Faruk Mula-Bagerist
Rrahman Franca - Makinist Bagerist
Rrahman Franca -Mekanist
Asad Lajqi
Ahmet Zekaj
Danush Bojaj
Brahim Abdullahi
Granit Zekaj



Pas Kërkesë për Rishqyrtim dt 24.12.2022, me dt 30.12.2022 kemi marrë përgjigje nga AK duke na aprovuar pjesërisht piken 1 të Kërkesen për Rishqyrtim, kurse për piken 2 të Njoftimit për eliminim nuk janë marrë për bazë fare arsytime dhe sqarimet tona, duke mos sqaruar apo komentuar disa sqarime dhe arsytme tona.

AK, duke sqaruar piken 2 të Njoftimit për Eliminim thirret në RREGULLAT E RRUOPP-së konkretisht në "NENIN 38.3" i cili nuk ka të bëjë me qështjen tonë:

(38.3 Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet: a. tu eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe b. tu shënohen nga një kod.)

duke aluduar në Nenin 39.3 të RREGULLAT E RRUOPP-së :

39.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.

Pikërishtë, dokumentet e dorëzuara përcaktojnë gjendjen egzistuese të punëtorëve dhe -në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë dhe më gjatë.

- Prandaj, dokumentacioni i dorëzuar argumenton dhe pasqyron gjendjen faktike të punëtorëve që do të angazhohen për këtë projekt dhe fakti që të gjithë punëtorëve jupaguhën të gjitha kontributet dhe janë në Listen e të punësuarve në ATK (lehtë të verifikueshme), AK mundet të verifikoj edhe pa kërkuar fare informacione shtesë nga ne.

- Dokumentacioni i dorëzuar i plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes së tenderit, konkretisht Kapaciteti teknik dhe profesional në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura kërkoj nga OSHP që të merr këtë:

V E N D I M

1. APROVOJ - si të bazuar Ankesën e ER-LIS SHPK

2. ANULOJ - Vendimin për dhenje të kontratës dt 21.12.2022

3. URDHËROJ - AK që Aktivitetin e Prokurimit: Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish 21shit dhe ish-Shtypshkronjës së Rilindjes ta kthejë në rivlerësim meritore.

Operatori Ekonomik BLENOR SHPK në ankesën e tij pretendon se janë shkelur dispozitat si në vijim:

Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Kompania Blenor shpk pas Njoftimit të Vendimit nga A.K dhe Letër Standarte për tenderusin e eliminuar me dt. 21.12.2022 ju është drejtuar me kërkesë për qasje në dokumente zyrtare të cilin na e kanë mundësuar me korrektesë me dt. 22.12.2022.

Në mëndej se kompania tonë i është bërë e padrejtë sepse ne kemi dorëzuar Listen e Stafit Professional konform kërkesave të A.K.-s

E vetmja arsye e eliminimit tonë sipas A.K është numri i punëtorëve në Listen e Stafit Professional të paraqitur nga kompania jonë.

Në Kërkesën e A.K-s në mënyrë decizive kërkohej personeli për realizimin e projektit min. 15 punëtor.

Kompania jonë ka ofruar Listen me 6 punëtor të rregullt nga ATK dhe 9 punëtor me Kontratë mbi Veprë për këtë Projekt, të bashkangjitur gjëni deshmim:

Është apsuriteti i llojit të vetë se si menaxheri i kontratës llogaritet nga ATK si punëtor ndërsa sipas A.K ai nuk mund të llogaritet punëtor.

Shpresoj se ankesa jonë të Aprobëhet si e bazuar dhe lenda të kthehet në Ri-Vlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish 21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesat e deponuara ne OSHP, janë te njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet te ofroje dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues së qarkullimi vjetor i OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare ka qene jo me pak së 180,000.00€.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për periudhën e shkuar trevjeçare.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Një menaxher për projektin. Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar apo Master i Ndërtimtarisë drejtimi - Konstruktiv ose inxhinier i diplomuar ose master i Arkitekturës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.	Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV-mbi përvojen e punës në lëmin e kërkuar, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt me punëdhënësin-kopje. Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi.
		2. Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor.	2. Lista e stafit profesional të angazhuar për këtë projekt e nënshkruar dhe e vulosur nga OE Kontratat osë marrëveshjet e punës valide për këtë projekt për stafin e angazhuar.
		3. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të suksess projekte të natyrës së ngjashme të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak së 130.000.00euro (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare).	3. Lista e projekteve të realizuara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projektet e realizuara në lëmin e kërkuar (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare), duke bashkëngjitur referenc ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projektit.
		4. OE duhet te ketë, dëshmoj, Makineri dhe pajisje adekuate per demolime dhe makineri adekuate per transportin e materialit te demoluar për realizim të projektit.	4. Lista e pajisjeve qe posedoni për demolim dhe lista e makinerisë qe posedoni, duke bashkëngjitur dëshmitë e pronësisë ose marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre.
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët]; <input checked="" type="checkbox"/> apo	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave te ish21shit dhe ish shtypshkronjës se Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve te Brendshme.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Dokument	"CONFORIST ISAAT SANAYI VE TICARET LIMITED SIRKET L.T.D." -DEGA KOSOVË	BLENOR SH.P.K.	"L-Group" SH.P.K.
1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënqashme Autoritetit kontraktues të qarkullimit vijtor i OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare ka qene jo me pak se 180.000.00€.	Ne pajtim / Nuk dëshmohet	Ne pajtim / Nuk dëshmohet	Ne pajtim / Nuk dëshmohet
	I papajtoeshëm	Ne pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare:

OE: "CONFORIST ISAAT SANAYI VE TICARET LIMITED SIRKET L.T.D." -DEGA KOSOVË - nuk keni ofruar dëshmi të kënqashme se qarkullimi vijtor i OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare ka qene jo me pak se 180.000.00€.

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokument	ER - LIS SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik MBB Construction SH.P.K.; N.T.SH. QAMILI	"LURN" SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik - UNIQUE SH.P.K.; Astraplan SH.P.K.	NIKA Pro- ing SH.P.K.
1. Një menaxher për projektin. Menaxheri i projektit duhet të jetë Inzhinier i Diplomuar apo Master i Ndërtimitarët drejtimi - Konstruktiv ose Inzhinier i diplomuar ose master i Arkitektues - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.	Ne pajtim / Nuk dëshmohet	Në pajtim	Ne pajtim / Nuk dëshmohet	Ne pajtim / Nuk dëshmohet	Ne pajtim / Nuk dëshmohet
2. Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor.	I papajtoeshëm	I papajtoeshëm	Ne pajtim	Ne pajtim	Në pajtim
3. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënqashme me sukses projekte të natyrës së ngjashme të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak se 130.000.00euro (nga Njoftimi për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare).	Në pajtim	Në pajtim	Ne pajtim	Ne pajtim	Në pajtim
4. OE duhet të keni dëshmi, Makineri dhe pajisje të kësaj natyre për demolicion dhe makineri adekuate për transportin e materialit të demoluar për realizimin e projektit.	Në pajtim	Ne pajtim	Ne pajtim	Ne pajtim	Në pajtim

Dokument	"CONFORIST ISAAT SANAYI VE TICARET LIMITED SIRKET L.T.D." -DEGA KOSOVË	BLENOR SH.P.K.	"L-Group" SH.P.K.
1. Një menaxher për projektin. Menaxheri i projektit duhet të jetë Inzhinier i Diplomuar apo Master i Ndërtimitarët drejtimi - Konstruktiv ose Inzhinier i diplomuar ose master i Arkitektues - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.	Ne pajtim / Nuk dëshmohet	Ne pajtim / Nuk dëshmohet	Ne pajtim / Nuk dëshmohet
	Në pajtim	Në pajtim	I papajtoeshëm

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

OE: ER - LIS SH.P.K., Ju nuk keni ofruar Vendimin për menaxherin e kontratës, siç kane qen kërkesat ne njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit.

2. Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor. Ju keni ofruar dëshmi vetëm për 9 nga stafi i cili do te angazhohet për këtë projekt.

OE: "CONFORIST ISAAT SANAYI VE TICARET LIMITED SIRKET L.T.D." -DEGA KOSOVË. Ju nuk keni ofruar dëshmi se keni përfunduar me sukses projekte të natyrës së ngjashme të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak se 130.000.00euro (nga Njoftimi për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare).

OE: "L-Group" SH.P.K.- Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor. Ju NUK keni ofruar dëshmi për stafin i cili do te angazhohet për këtë projekt, siç kane qen kërkesat ne njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit, Duke mos dëshmuar kontratat ose marrëveshjet valide me stafin e prezantuar.

2. Juv. ju mungon CV e menaxherit te kontratës te cilen e keni prezantuar,
3. Diploma e prezantuar nuk ka noterizim.

OE: BLENOR SH.P.K.- Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor. Ju keni ofruar dëshmi vetëm për 14 nga stafi i cili do te angazhohet për këtë projekt.

OE: Grup i Operatorëve Ekonomik MBB Construction SH.P.K.; N.T.SH. QAMILI- Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor. Ju NUK keni ofruar dëshmi për stafin i cili do te angazhohet për këtë projekt, siç kane qen kërkesat ne njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit, Duke mos dëshmuar kontratat ose marrëveshjet valide me stafin e prezantuar.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolimi, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish21shit dhe ish shtypshkronjës se Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme.

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Komisioni i vlerësimit të ofertave pas ekzaminimit, vlerësimit, krahasimit dhe shqyrtimit të tërësishëm të dokumentacionit me të cilin ka disponuar, duke u bazuar në kriterin për dhënie të kontratës të përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit. (Tendeni i përgjigjshëm me çmimin më të ulët), dhe sipas komisionit për vlerësimin e ofertave konstaton dhe vlerëson që operatori ekonomik i cili i plotëson kriteret për të shpërblyer me kontratë është:

- Operatori Ekonomik: " LURN " SH.P.K., Rr Abedin Sogojeva, 12000, Fushe Kosove, Kosovë, të shpërblyhet me Kontratë, me çmimin e përgjithshëm të ofertës në shumën e përgjithshme prej: 81.500.30€;

OE në fjalë i plotësojnë të gjitha kriteret të paraqitura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, dhe për të njëjtit rekomandohet udhëheqësi i divizionit të prokurimit që të shpërblyhet me kontratë për këtë AP.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Operatorët Ekonomik janë pjesë e procedurës së prokurimit prandaj vlerësohet se është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ER-LIS Shpk" DHE BLENOR Shpk

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ER-LIS SHPK"

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomik ankues, dhe rrjedhës së procedurës së tenderimit sqaron si në vijim:

Pretendimi ankimor Nr. 1

Njoftimi për eliminim dt 24.12.2022 me arsyetimin se:

1. Nuk kemi ofruar Vendimin për Menaxherin e Kontrates, siç kanë qenë kërkesat në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e Tenderit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme.

2. Përsonei për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor. Ju keni ofruar dëshmi vetëm për nëntë nga stafi i cili do të angazhohet për këtë projekt. Për Kërkesen 2 ne DT është kërkuar

Pas Njoftimit për eliminim kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim dt 24.12.2022 me sqarime:

Për Kërkesen 1 ne DT është kërkuar

Kërkeses 2: Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

KERKESA 1. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV-mbi përvojën e punës në lëmin e kërkuar, kontrata ose marrëveshja e punësvalide për këtë projekt me punëdhënësin-kopje. Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi.

Kërkesa 1, kemi dorëzuar:

-Diplomen e noterizuar përkatëse nga origjinali

-CV-mbi përvojën e e punës në lëmin e kërkuar

-Kontraten për këtë projekt me **vendim** për caktimin e **Menaxherit** të projektit i nënshkruar nga Punëmarrësi, nënshkrua dhe vulosur nga Punëdhënësi.

Dëshmi 1: KONTRATË PUNE

- PËR KOHË TË KATUAR 06.12.2022

.....
- Punëmarrësi: **SH. P.**, i lindur, No LN: 72 me profesion: **Inxhinjer i diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv**

Neni 2

I punësuari do të kryej punët si: **Menaxher i Projektit**

Neni 3

Për Projektin- Titulli: Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish 21shit dhe ish-Shtypshkronjës së Rilindjes Nr i prokurimit 214-22-13394-5-2-1

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues për kërkesën që ka të bëjë me Menaxherin e Projektit dhe vendimin për caktimin e Menaxherit të projektit ekspertit shqyrtues konstaton se OE ankues në ofertën e tij ka të përfshirë stafin i cili është i kontraktuar për këtë projekt sipas kërkesës së AK-së e datuar me 06.12.2022 për projektin "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish 21shit dhe ish- Shtypshkronjës së Rilindjes" ku sipas Nenit 2 të kushteve të Kontratës i punësuari do të kryejë punët si: Menaxher i Projektit.

Poashtu OE ankues në ofertën e tij ka përfshirë edhe diplomën e Inxhinierit Sh. P. i cili sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit është Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë dega Konstruktiv, me diplomë të noterizuar të noteri me numër të protokollit 2702/2022 si dhe me përvojën e mjaftueshme sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit.

AK-ja në vendimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues në këtë procedurë të shqyrtimi i kërkesës së OE ankues ER-LIS Shpk ka deklaruar se **"Ndërsa sa i përket kërkesave për pikat e cekur në letrën standarde për eliminim, kërkesa juaj është pjesërisht e pranuar"**.

AK-ja nuk e ka specifikuar se cili pretendim ka qenë pjesërisht i pranuar.

Duke pas parasysh se në "letrën standarde për tenderuesin e eliminuar" njëra nga arsyet e eliminimit ka qenë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme.

vendimi për Menaxherin e Kontratës derisa në vendimin e AK-se se kërkesës për rishqyrtim nuk është përmendur si arsye e eliminimit atëherë eksperti shqyrtues konstaton se AK-ja ka pranuar pretendimin e OE ankues si të bazuar dhe e ka eliminuar si SHKAK për eliminim nga procedura pjesën e Vendimit të Menaxherit të Projektit.

Sidoqoftë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues që ka të bëjë me pjesën e Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 kërkesa 1 Një menaxher për projektin. Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar apo Master i Ndërtimtarisë drejtimi - Konstruktiv ose inxhinier i diplomuar ose master i Arkitekturës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV-mbi përvojën e punës në lëmin e kërkuar, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt me punëdhënësin-kopje.

Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi

është e përmbushur nga OE ankues dhe rrjedhimisht e pranuar edhe nga AK-ja në vendimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 30.12.2022.

Përfundim:

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimit të Operatorit Ekonomik ankues vlerëson se pretendimi është i bazuar.

Pretendimi ankimor Nr. 2

Kerkeses 2: *Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:*

Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor

Lista e stafit profesional të angazhuar për këtë projekt e nënshkruar dhe e vulosur nga OE Kontratat ose marrëveshjet e punës valide për këtë projekt për stafin e angazhuar.

Pësoneli për realizimin e projektit – Punëtorëve për këtë projekt, siq janë kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në DT, në kemi marrëveshje me 9 punëtor me kontrata për këtë projekt e po ashtu kemi dëshmi nga ATK se kompanija ka edhe 7 punëtor të përhershëm. Që do thotë se për këtë projekt janë angazhuar 17 pësona.

Kemi dorëzuar Dëshmia 1:

LISTA e punetoreve 2022 ATK

Dëshmia 2:

Lista e punetorev 06.12.2022- e nënshkruar dhe vërtetuar

Pas Kërkesë për Rishqyrtim dt 24.12.2022, me dt 30.12.2022 kemi marrë përgjigje nga AK duke na aprovuar pjesërisht piken 1 të Kerkesen për Rishqyrtim, kurse për piken 2 të Njoftimit për eliminim nuk janë marrë për bazë fare arsytime dhe sqarimet tona, duke mos sqaruar apo komentuar disa sqarime dhe arsytme tona.

AK, duke sqaruar piken 2 të Njoftimit për Eliminim thirret në RREGULLAT E RRUOPP-së konkretisht në "NENIN 38.3" i cili nuk ka të bëjë me qështjen tonë:

(38.3 Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet: a. tu eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe b. tu shënohen nga një kod.)

duke aluduar në Nenin 39.3 të RREGULLAT E RRUOPP-së :

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR - lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme.

39.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Pikërisht, dokumentet e dorëzuara përcaktojnë gjendjen ekzistuese të punëtorëve dhe -në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë dhe më gjatë.

- Prandaj, dokumentacioni i dorëzuar argumenton dhe pasqyron gjendjen faktike të punëtorëve që do të angazhohen për këtë projekt dhe fakti që të gjithë punëtorëve jupaguhet të gjitha kontributet dhe janë në Listen e të punësuarve në ATK (lehtë të verifikueshme), AK mundet të verifikoj edhe pa kërkuar fare informacione shtesë nga ne.

- Dokumentacioni i dorëzuar i plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes së tenderit, konkretisht Kapaciteti teknik dhe profesional në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë me numrin e stafit të angazhuar në këtë projekt ekspert shqyrtues sqaron se OE ankues në ofertën e tij ka dorëzuar dy lista të stafit profesional që do të angazhohen në këtë projekt.

Në listën e parë janë 7 anëtar të personelit të cilët OE ankues i ka në listën e punëtorëve të përhershëm të cilëve ju paguan edhe kontributet Pensionale në përputhje me Ligjet në fuqi si dhe një listë të dytë prej 10 punëtorëve në të cilën paraqiten staf profesional i cili është angazhuar me kontratë/marrëveshje për projektin.

OE ankues ka dorëzuar 10 kontrata pune me kohë të caktuar të angazhuar për këtë projekt derisa për pjesën e stafit të përhershëm nuk ka përfshirë kontratat e punës.

Bazuar në nenin 38.3 të RRPP 001/2022 "Megjithatë, lejohet që një autoritet gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë."

Poashtu sipas LPP-se Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Eksperti shqyrtues konstaton se pasqyra e ATK-se pasqyron në mënyrë objektive gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, poashtu në bazë të LPP-se neni 72 AK mund të kërkojë nga OE që të plotësojnë dokumentacionin. Duke pasqyruar dokumentet zyrtare të prodhuara nga institucione kredibile si ATK ekspert shqyrtues mendon se vlerësimi i AK-se në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim se "kontratat për punëtorë nuk janë të verifikueshme sepse prodhohen nga OE" nuk qëndron.

Përfundim:

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimit të Operatorit Ekonomik ankues dhe në mbështetje të nenit 38.3 të RRPP 001/2022 si dhe nenit 72.1 vlerëson se pretendimi është **i bazuar**.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "BLENOR SHPK"

Pretendimi ankimor Nr. 1

Kompania **Blenor shpk** pas Njoftimit të Vendimit nga A.K dhe Letër Standarte për tenderisin e eliminuar me dt. 21.12.2022 ju është drejtuar me Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare të cilin na e kanë mundësuar me korrektesi me dt. 22.12.2022.

Në mendim se kompania tonë i është bërë e padrejt sepse ne kemi dorëzuar **Listen e Stafit Professional** konform kërkesave të A.K.-s.

E vetmja arsye e eliminimit tonë sipas A.K është numri i punëtorëve në **Listen e Stafit Professional** të paraqitur nga kompania jonë.

Në Kërkesën e A.K-s ne menjëherë decidive kërkojmë personeli për realizimin e projektit min. 15 punëtor.

Kompania jonë ka ofruar **Listen** me 6 punëtor të rregullt nga ATK dhe 9 punëtor me Kontratë mbi Veprë për këtë Projekt të bashkangjitur gjëni deshmim.

Është apsurditet i llojit të vet se si menaxheri kontratës llogaritet nga ATK si punëtor ndërsa sipas A.K ai nuk mund të llogaritet punëtor.

Shpresoj se ankesa jonë të Apropohet si e bazuar dhe lenda të kthehet në Ri-Vlersim.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues që ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 2. Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor.

Lista e stafit profesional të angazhuar për këtë projekt e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE Kontratat ose marrëveshjet e punës valide për këtë projekt për stafin e angazhuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka të përfshirë listën e stafit profesional prej 15 vetave prej të cilëve 10 janë me kontratë me afat të caktuar dhe 5 janë punëtorë të rregullt të cilëve ju paguhet kontributet sipas ligjeve në fuqi.

Operatori ekonomik ankues në ofertën e tij ka përfshirë 11 kontrata të punës derisa për personelin e rregullt sipas listës së ATK të bashkangjitur me oferte me numër rendor 1. Adelina Ibrahimaj, 2. Armend Lullaku, 4. Selman Lullaku dhe 6. Visar Sinani nuk ka bashkangjitur kontratat e punës.

Eksperti shqyrtues vlerëson se sa i përket pjesës ku AK-ja e eliminon OE ankues me arsyetimin se Menaxheri i Projektit nuk mund të përfshihet në listën e stafit profesional të angazhuar për këtë projekt nuk është bërë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe Nenit 59 par. 1 dhe 4 të LPP-së.

Kërkesa e dosjes së tenderit. Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor.

Lista e stafit profesional të angazhuar për këtë projekt e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE Kontratat ose marrëveshjet e punës valide për këtë projekt për stafin e angazhuar.

AK-ja në asnjë rast nuk e ka specifikuar se Menaxheri i Projektit duhet të jete i përjashtuar nga lista. Për më tepër kërkesa specifikon se stafi duhet të jete i angazhuar për këtë projekt që nënkuptohet se edhe Menaxheri i Projektit është i përfshirë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme.

Eksperti shqyrtues i vë ne vëmendje te PSH se AK-ja në rastin e OE ankues ERLIS Shpk një nga arsyet e eliminimit me rastin e refuzimit te kërkesës për rishqyrtim ka qene **"Ju NUK keni ofruar dëshmi për stafin i cili do te angazhohet për këtë projekt, siç kane qene ne kërkesat për njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit, Duke mos dëshmuar kontratat ose marrëveshjet valide me stafin e prezantuar"**.

Ndërsa ne rastin e OE ankues Blenor Shpk përkundër faktit se OE ankues kishte ofruar vetëm 11 kontrata për stafin profesional te angazhuar për këtë projekt arsye te eliminimit ne letren standarde ka qene **"Ju keni ofruar dëshmi vetëm për 14 nga stafi i cili do te angazhohet për këtë projekt"**.

Prandaj konstatojmë se AK-ja kishte përdorur standarde të dyfishta në vlerësimin e ofertave për të njëjtin projekt. Kjo është bërë ne kundërshtim me Nenin Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve **Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

Përfundim:

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimit të Operatorit Ekonomik ankues vlerëson se pretendimi është **i bazuar.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:

- Ankesat e Operatoreve Ekonomik **ER-LIS SHPK** dhe **BLENOR SHPK** të aprovohen **SI TË BAZUARA**,

Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|------------------------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME. |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP. |
| - OE ankues | - ER-LIS SHPK. |
| - OE ankues | - BLENOR SHPK. |
| - | |

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ER LIS" dhe BLENOR -, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave te ish21shit dhe ish shtypshkronjës se Rilindjes, me numër të prokurimit: 214-22-13394-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve te Brendshme.